

VENDIM
Nr. 513, datë 13.7.2016

PËR PJESËMARRJEN E NJË TOGE KËMBËSORIE TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ME MISION, NË KOMANDËN
E TRAJNIM-KËSHILLIMIT DHE NDIHMËS NË HERAT, NË KUADËR TË
OPERACIONIT TË NATO-s “RSM”, AFGANISTAN

(Ndryshuar me VKM nr. 695, datë 9.9.2020)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, dhe 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr.64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin, me mision, të një toge këmbësorie të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të përbërë nga 40 (dyzet) ushtarake, pranë Komandës së Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës në Herat, Afganistan.

2. Misioni i togës është ruajtje baze (*force protection*) në Komandën e Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës në Herat, në kuadër të operacionit të NATO-s “RSM”, në Afganistan.

3. Toga nuk mund të përdoret për detyra të tjera, përveç ruajtjes, brenda perimetrit, të bazës ushtarake të Komandës së Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës në Herat, Afganistan.

4. *Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 10 dhjetor 2021.* Periudha e qëndrimit në mision, për çdo kontingjent, do të jetë me sistem rotacioni në çdo 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës (marrjen dhe dorëzimin e detyrës, vonesa të transportit strategjik).

5. Venddislokimi i kësaj toge do të jetë në Komandën e Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës në Herat, Afganistan.

6. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, të përballojë shpenzimet për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

ç) mbështetje shëndetësore;

d) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

dh) transport;

e) transportimin e individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerje disipline;

ë) aktivitete social-kulturore, në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit;

f) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

7. Transportimi i personelit, që do të shërbejë në Afganistan, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lanateria, transportimi i individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, me përjashtim të rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe, ku pala tjetër merr përsipër të përballojë këto shpenzime.

8. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

10. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi